FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 18

Tiranë – E premte, 23 janar 2026

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 20, datë 21.1.2026	Për transferimin në pronësi të Bashkisë Krujë të disa pronave dhe për disa shtesa në vendimin nr. 242, datë 6.3.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Krujë, të qarkut të Durrësit".....	1691
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 21, datë 21.1.2026	Për disa ndryshime në vendimin nr. 532, datë 8.7.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave tek Agjencia Shtetërore e kadastrës, të pasurisë 2/128, zona kadastrale 8541, Njësia Administrative Gjirokastër, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 660, datë 4.8.2010, të Këshillit të Ministrave, 'Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave', të ndryshuar"	1696
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 22, datë 21.1.2026	Për miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në Vlashaj, Njësia Administrative Shupenzë, Bashkia Bulqizë, qarku Dibër, nga shoqëria "Gerti" sh.p.k.....	1697
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 23, datë 21.1.2026	Për miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike eolike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në Njësinë Administrative Mollaj, Bashkia Korçë, qarku Korçë, nga bashkimi i përkohshëm i shoqërive "Albpower" sh.p.k., "Favina" sh.p.k. dhe "Favina 1" sh.p.k.....	1700
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 31, datë 21.1.2026	Për miratimin e planit të shpenzimeve, për vitin 2026, të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU)	1703
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 36, datë 21.1.2026	Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor, për vitin 2026.....	1704

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 37, datë 21.1.2026	Për përcaktimin e organizimit të brendshëm të organeve drejtuese e të mënyrës së funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve sh.a.....	1708
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 38, datë 21.1.2026	Për hapjen e procedurës së pranimit të drejtpërdrejtë në TND edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil dhe për përdorimin e procedurës së pranimit të drejtpërdrejtë në TND, për vitin 2026.....	1710
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 39, datë 21.1.2026	Për planin vjetor të pranimit, për vitin 2026, në institucionet e administratës shtetërore, pjesë të shërbimit civil	1711
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 40, datë 21.1.2026	Për shpalljen e disa zonave me përparësi zhvillimin e ekonomisë malore në Bashkinë Dibër.....	1712
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 41, datë 21.1.2026	Për shpalljen e disa zonave me përparësi zhvillimin e ekonomisë malore në Bashkinë Memaliaj.....	1730
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 21.1.2026	Për shpalljen e disa zonave me përparësi zhvillimin e ekonomisë malore në Bashkinë Tepelenë.....	1732
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 43, datë 21.1.2026	Për emërimin në detyrë të drejtorit të përgjithshëm të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.....	1735
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 134/1, datë 19.1.2026	Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 147, datë 13.3.2023, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti 'Ndërtimi i linjës 110 kV Unaza e Tiranës'".....	1735

VENDIM
Nr. 20, datë 21.1.2026

PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË KRUJË TË DISA PRONAVE DHE PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 242, DATË 6.3.2009, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË KRUJË, TË QARKUT TË DURRËSIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 7 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi të Bashkisë Krujë të pronave me numrat rendorë 437–443, sipas shtojcës nr. 1, formularëve dhe planeve të rilevimit, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Pronat sipas shtojcës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, i shtohen lidhjes 1, që i bashkëlidhet vendimit nr. 242, datë 6.3.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Krujë, të qarkut të Durrësit".

3. Ngarkohen Bashkia Krujë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA NR. 1

Numri rendor i pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronave	Lloji i transferimit të pronave
437–442	Për realizimin e funksioneve në fushën e pyjeve dhe të kullotave	Në pronësi
443	Për realizimin e funksioneve në fushën e shërbimeve funerale	Në pronësi

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE
(Per inventarizimin e pronave te veçanta)

Bashkia: Krujë
Njësia Administrative Thumanë
Fusha e perdorimit te Prones: Zhvillim ekonomik

Identifikoi: Klaudia Ziri (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar) Topografe Sp.Kadastrës S.Vogli
Supervizoi: Përgj Sektori Fehmi Mahmutaj (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)
Aprovoi: Artur Bushi Kryetari i Bashkisë (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, fat firma, vula)

	A			B						
Nr. Rend.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
437	1475 K-34-(120 A)	199	Kullote	Fshati Dërven Nj.A. Thumanë Bashkia Krujë	36288		Zhvillim ekonomik	Bashkia Kruje	Bashkia Kruje	pjese e pasurise 199
438	1475 K-34 120-A	200	Kullote	Fshati Dërven Nj.A. Thumanë Bashkia Krujë	7582		Zhvillim ekonomik	Bashkia Kruje	Bashkia Kruje	
439	1475 K-34-88-119-D 120-C,120-A,	202/5	Kullote	Fshati Dërven Nj.A. Thumanë Bashkia Krujë	88755		Zhvillim ekonomik	Bashkia Kruje	Bashkia Kruje	Pjese e pasurise 202/5
440	1475 K-34-88 120-C120-A	203	Kullote	Fshati Dërven Nj.A. Thumanë Bashkia Krujë	3850		Zhvillim ekonomik	Bashkia Kruje	Bashkia Kruje	
441	1475 K-34-88 119-D 120-C, 120-A	227	Kullote	Fshati Dërven Nj.A. Thumanë Bashkia Krujë	20243		Zhvillim ekonomik	Bashkia Kruje	Bashkia Kruje	

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

(Per inventarizimin e pronave te veçanta)

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
442	1475 K-34-88 120-A,119-B	9/1/1	Kullote	Fshati Dërven Nj.A. Thumanë Bashkia Krujë	82270		Zhvillim ekonomik	Bashkia Kruje	Bashkia Kruje	

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

(Per inventarizimin e pronave te veçanta)

Bashkia: Krujë
Njësia Administrative Thumanë
Fusha e perdorimit te Prones: Sherbim Funeral

Identifikoi: Klaudia Ziri Topograf Sp Kadastrës S.Vogli
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Supervizoi: Përgj Sektori Fehmi Mahmutaj
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Aprovoi: Artur Bushi Kryetari Bashkisë
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)

	A			B			C			
Nr. Rend.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
443	1475 K-34-88 119-B; 120-A	9 / 1 / 1	Kullotë	Fshati Dërven Nj.A. Thumanë Bashkia Krujë	13615		Varreza	Bashkia Krujë	Bashkia Krujë	Pjese e pasurise 9/1/1

PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

PRONARI SHTETI DATE 08 / 09 / 2025 QELLIMI TRANSFERIM PASURIE

VENDNDODHJA
BASHKIA DERVEN, KRUJE
TE DHENAT E PASURISE
LLOJI PASURISE KULLOTE

DVASHK/ZVASHK KRUJE ZONA KADASTRALE 1475 NUMRI PASURISE 199,200,202/5 203,227,9/1/1 INDEX HARTE K-34-88-(120-A) K-34-88-(120-C) K-34-88-(119-B) K-34-88-(119-D)

SIP.PASURISE =504650 m² SIPERFAQE GJURMES NDERTIMIT= --- m² NUMRI KATEVE --- NUMRI PEMEVE ---

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



SH 1: 5000

Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT
1						
2						
3						
....						

REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT
EMRI: ING. JAK SULI
LICENCA: NR. 4509 / 6 DATE 31.01.2022
KOMPANIA: "GEOMATIKA"
NIPT: K 51401001T
NENSHKRIMI/VULA Jak
Digitally signed by Jak Suli Date: 2025.09.08 13:04:11 +02'00'
REALIZOI PER ASHK Suli
SPECIALISTI
DVASHK
NENSHKRIMI
KONFIRMOI
PERGJEGJESI/DREJTORI
NENSHKRIMI / VULA

TEKNOLOGJIA E MATJEVE: Z
KODE PER TEKNOLOGJINE E MATJEVE: T-TERREN; Z-ZYRE; O-ORTOFOTO; G-GPS; S-STACION TOTAL; D-MATJE DISTANCASH;
PERCAKTIMI KUFIRIT: HK
KODE PER PERCAKTIMIN E KUFIRIT: P-PËRFAQËSUES I PRONARVE; K-KUFITARËT TË GJITHË; KP-KUFITARËT PJESËRISHT; PB-PËRFAQËSUES BASHKIE, HK-HARTA KADASTRALE;
SHENIME TE VECANTA:

PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET
EMRI SHTETI
NENSHKRIMI

MIRATOHET
DREJTORI
ARBER BUSHI
REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA KRUJE

KODE PER TEKNOLOGJINE E MATJEVE DHE PERCAKTIMI KUFIRIT: T-TERREN; Z-ZYRE; O-ORTOFOTO; G-GPS; S-STACION TOTAL; D-MATJE DISTANCASH; P-PËRFAQËSUES I PRONARVE; K-KUFITARËT TË GJITHË; KP-KUFITARËT PJESËRISHT; PB-PËRFAQËSUES BASHKIE, HK-HARTA KADASTRALE

PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

PRONARI SHTETI DATE 08 / 09 / 2025 QELLIMI TRANSFERIM PASURIE

VENDNDODHJA
BASHKIA DERVEN, KRUJE
TE DHENAT E PASURISE
LLOJI PASURISE KULLOTE

DVASHK/ZVASHK KRUJE ZONA KADASTRALE 1475 NUMRI PASURISE 9/1/1 INDEX HARTE K-34-88-(119-B) K-34-88-(119-D)

SIP.PASURISE = 356130 m² SIPERFAQE GJURMES NDERTIMIT= --- m² NUMRI KATEVE --- NUMRI PEMEVE ---

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



SH 1: 5000

Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT
1						
2						
3						
....						

REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT
EMRI: ING. JAK SULI
LICENCA: NR. 4509 / 6 DATE 31.01.2022
KOMPANIA: "GEOMATIKA"
NIPT: K 51401001T
NENSHKRIMI/VULA Jak Suli
Digitally signed by Jak Suli Date: 2025.09.08 11:04:11 +02'00'

REALIZOI PER ASHK
SPECIALISTI _____
DVASHK _____
NENSHKRIMI _____

KONFIRMOI
PERGJEGJESI/DREJTORI _____
NENSHKRIMI / VULA _____

TEKNOLOGJIA E MATJEVE: Z
KODE PER TEKNOLOGJINE E MATJEVE: T-TERREN; Z-ZYRE; O-ORTOFOTO; G-GPS; S-STACION TOTAL; D-MATJE DISTANCASH;
PERCAKTIMI KUFIRIT: HK
KODE PER PERCAKTIMIN E KUFIRIT: P-PËRFAQËSUES I PRONARVE; K-KUFITARËT TË GJITHË; KP-KUFITARËT PJESËRISHT; PB-PËRFAQËSUES BASHKIE, HK-HARTA KADASTRALE

SHENIME TE VECANTA:

PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET

EMRI SHTETI
NENSHKRIMI _____

REPUBLIKA E SHQIPERISE BASHKIA KRUJE
MIRATOHET
KRYETARI
ARTUR BUSHLI

KODE PER TEKNOLOGJINE E MATJEVE DHE PERCAKTIMI KUFIRIT: T-TERREN; Z-ZYRE; O-ORTOFOTO; G-GPS; S-STACION TOTAL; D-MATJE DISTANCASH; P-PËRFAQËSUES I PRONARVE; K-KUFITARËT TË GJITHË; KP-KUFITARËT PJESËRISHT; PB-PËRFAQËSUES BASHKIE, HK-HARTA KADASTRALE

VENDIM
Nr. 21, datë 21.1.2026

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 532, DATË 8.7.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARKIVAVE TEK AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS, TË PASURISË 2/128, ZONA KADASTRALE 8541, NJËSIA ADMINISTRATIVE GJIROKASTËR, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 660, DATË 4.8.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË ARKIVAVE", TË NDRYSHUAR"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 532, datë 8.7.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave tek Agjencia Shtetërore e Kadastrës, të pasurisë 2/128, zona kadastrale 8541, Njësia Administrative Gjirokastër, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 660, datë 4.8.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 1, togfjalëshi, "... të truallit me sipërfaqe 774 m^2, katit bodrum, me sipërfaqe 74.4 m^2, katit përdhes me sipërfaqe 220.7 m^2 dhe katit të parë 282.7 m^2, ..." zëvendësohet me "... të truallit me sipërfaqe 742 (shtatëqind e dyzet e dy) m^2, katit bodrum me sipërfaqe 74.4 (shtatëdhjetë e katër pikë katër) m^2, katit përdhes me sipërfaqe 275 (dyqind e shtatëdhjetë e pesë) m^2, katit të parë me sipërfaqe 282.7 (dyqind e tetëdhjetë e dy pikë shtatë) m^2 dhe katit të dytë me sipërfaqe 221.7 (dyqind e njëzet e një pikë shtatë) m^2, ...";

b) Në pikën 2, togfjalëshi "Pjesa e pasurisë 2/128" zëvendësohet me "Pasuria nr. 2/128";

c) Planimetria e katit të dytë, bashkëlidhur vendimit, zëvendësohet me planimetrinë, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



VENDIM
Nr. 22, datë 21.1.2026

PËR MIRATIMIN E NDËRTIMIT TË CENTRALIT GJENERUES TË ENERGJISË ELEKTRIKE FOTOVOLTAIKE DHE VEPRAVE NDIHMËSE, I CILI NUK ËSHTË OBJEKT KONCESIONI, NË VLASHAJ, NJËSIA ADMINISTRATIVE SHUPENZË, BASHKIA BULQIZË, QARKU DIBËR, NGA SHOQËRIA "GERTI" SHPK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni dhe nuk përfiton nga masat mbështetëse, në Vlashaj, njësia administrative Shupenzë, Bashkia Bulqizë, qarku Dibër, nga shoqëria "GERTI" sh.p.k., me elementet, si më poshtë vijon:

a) Emri i aplikuesit: Shoqëria "GERTI" sh.p.k.;

b) NIPT/NUIS: J96829417K;

c) Tipi i centralit: Fotovoltaik;

ç) Kapaciteti i instaluar: 10 mw;

d) Afati i pritshëm i vënies në punë dhe pajisja me leje ndërtimi: Koha për ndërtimin, pajisjen me lejen e ndërtimit dhe vënien në operim të impiantit fotovoltaik do të jetë brenda 36 (tridhjetë e gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;

dh) Vendndodhja e burimit gjenerues të energjisë: Në Vlashaj, Njësia Administrative Shupenzë, Bashkia Bulqizë, qarku Dibër;

e) Afati i operimit: 49 (dyzet e nëntë) vjet nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;

ë) Koordinatat e zonës së projektit dhe plan-vendosja, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

f) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore kanë të drejtë të ushtrojnë mbikëqyrje të përgjithshme, me afate 3-mujore gjatë realizimit, vënies në punë dhe operimit, me synim që të verifikojnë se ecuria e punimeve, cilësia, konformiteti dhe operimi janë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit e dokumentacionin e projektit;

g) Shoqëria "GERTI" sh.p.k., ka detyrimin që:

i. të paraqesë periodikisht (çdo tre muaj) pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore informacion për ecurinë e ndërtimit të centralit fotovoltaik;

ii. të respektojë kushtet e cituara në lejet, licencat dhe autorizimet paraprake mjedisore, lëshuar nga institucionet përgjegjëse kombëtare;

iii. të dorëzojë sigurimin e kontratës, në masën jo më pak se 5% të vlerës së investimit, përpara nënshkrimit të kontratës, ndërmjet shoqërisë "GERTI" sh.p.k., dhe ministrisë. Në këtë kontratë përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve për realizimin e këtij projekti, penalitetet, në rast mosrealizimi, si dhe çështje të tjera që lidhen me zbatimin e saj;

iv. t'i japë falas, në formë *royalty*, ministrisë përgjegjëse për energjinë sasinë e energjisë elektrike, në masën 2 (dy) % të sasisë vjetore të prodhimit të energjisë elektrike ose konvertimin e saj në vlerë monetare; në rast konvertimi në vlerë monetare, shuma duhet të derdhet tërësisht në buxhetin e shtetit;

v. të përmbushë kërkesën, sipas rastit, që një pjesë e prodhimit të burimit gjenerues të energjisë t'i shitet furnizuesit publik, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shoqëria "GERTI" sh.p.k., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

ANEKSI 1
KOORDINATAT E ZONËS SË PROJEKTIT

KOORDINATAT E CENTRALIT ELEKTRIK FOTOVOLTAIK
NË VLASHAJ, NJËSIA ADMINISTRATIVE SHUPENZË, BASHKIA BULQIZË, QARKU DIBËR, SHOQËRIA "GERTI" SHPK

KRGJSH	
X	Y
533785.46	4600073.72
533681.20	4600078.71
533586.63	4600092.52
533501.82	4600119.03
533450.17	4600114.44
533396.17	4600097.71
533342.70	4600112.09
533277.68	4600113.54
533253.22	4600101.36
533208.19	4600060.53
533207.29	4600017.02
533213.63	4599979.29
533305.98	4599932.36
533421.51	4599895.60
533541.78	4599872.29
533635.08	4599873.07
533700.77	4599873.83
533782.67	4599916.98

Planvendosja e zonës së projektit



VENDIM
Nr. 23, datë 21.1.2026

PËR MIRATIMIN E NDËRTIMIT TË CENTRALIT GJENERUES TË ENERGJISË ELEKTRIKE EOLIKE DHE VEPRAVE NDIHMËSE, I CILI NUK ËSHTË OBJEKT KONCESIONI, NË NJËSINË ADMINISTRATIVE MOLLAJ, BASHKIA KORÇË, QARKU KORÇË, NGA BASHKIMI I PËRKOHSHËM I SHOQËRIVE "ALBPOWER" SHPK, "FAVINA" SHPK DHE "FAVINA 1" SHPK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI**:**

1. Miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike eolike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni dhe nuk përfiton nga masat mbështetëse, në Njësinë Administrative Mollaj, Bashkia Korçë, qarku Korçë, nga bashkimi i përkohshëm i shoqërive "ALBPOWER" sh.p.k., "FAVINA" sh.p.k. dhe "FAVINA 1" sh.p.k., me elementet, si më poshtë vijon:

a) Emri i aplikuesit: bashkimi i përkohshëm i shoqërive "ALBPOWER" sh.p.k., "FAVINA" sh.p.k. dhe "FAVINA 1" sh.p.k.;

b) Numri i identifikimit personal të zyrës së taksave NIPT/NUIS: "ALBPOWER" sh.p.k.: M23904001G; "FAVINA" sh.p.k.: J64104078V dhe "FAVINA 1" sh.p.k.: K54624001I;

c) Tipi i centralit: Eolik;

ç) Kapaciteti i instaluar: 55 mw me kapacitet tolerance deri në 5% më pak e këtij kapaciteti, bazuar në projektin përfundimtar të zbatimit;

d) Afati i pritshëm i vënies në punë dhe pajisja me leje ndërtimi: Koha për ndërtimin, pajisjen me lejen e ndërtimit dhe vënien në operim të impiantit eolik do të jetë brenda 48 (dyzet e tetë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;

dh) Vendndodhja e burimit gjenerues të energjisë: Njësia Administrative Mollaj, Bashkia Korçë, qarku Korçë;

e) Afati i operimit: 49 (dyzet e nëntë) vjet nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;

ë) Koordinatat e tokës dhe plan-vendosja sipas aneksit 1 bashkëlidhur këtij vendimi;

f) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore kanë të drejtë të ushtrojnë mbikëqyrje të përgjithshme me afate 3-mujore gjatë realizimit, vënies në punë dhe operimit, me synim që të verifikojnë se ecuria e punimeve, cilësia, konformiteti dhe operimi janë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit e dokumentacionin e projektit;

g) Bashkimi i përkohshëm i shoqërive "ALBPOWER" sh.p.k., "FAVINA" sh.p.k. dhe "FAVINA 1" sh.p.k., duhet të krijojë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit një shoqëri për qëllime të veçanta, për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit eolik. Bashkimi i përkohshëm i shoqërive "ALBPOWER" sh.p.k.,, "FAVINA" sh.p.k. dhe "FAVINA 1" sh.p.k., si dhe shoqëria për qëllime të veçanta do të jenë bashkërisht përgjegjëse për detyrimet sipas këtij miratimi dhe kontratës së nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë;

gj) Shoqëria për qëllime të veçanta solidarisht me bashkimin e përkohshëm të shoqërive "ALBPOWER" sh.p.k., "FAVINA" sh.p.k. dhe "FAVINA 1" sh.p.k., ka detyrimin që:

i. të paraqesë periodikisht (çdo tre muaj), pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, informacion për ecurinë e ndërtimit të centralit eolik;

ii. të respektojë kushtet e cituara në lejet, licencat dhe autorizimet paraprake mjedisore, lëshuar nga institucionet përgjegjëse kombëtare;

iii. të dorëzojë sigurimin e kontratës, në masën jo më pak se 5% të vlerës së investimit, përpara nënshkrimit të kontratës ndërmjet bashkimit të përkohshëm të shoqërive "ALBPOWER" sh.p.k., "FAVINA" sh.p.k. dhe "FAVINA 1" sh.p.k. dhe ministrisë. Në këtë kontratë përcaktohen të drejtat e detyrimet e palëve për realizimin e këtij projekti, penalitetet, në rast mosrealizimi, si dhe çështje të tjera që lidhen me zbatimin e saj;

iv. t'i japë falas, në formë *royalty*, ministrisë përgjegjëse për energjinë sasinë e energjisë elektrike në masën 2% të sasisë vjetore të prodhimit të energjisë elektrike ose konvertimin e saj në vlerë monetare. Në rast konvertimi në vlerë monetare,

shuma duhet të derdhet tërësisht në buxhetin e shtetit;

v. të përmbushë kërkesën, sipas rastit, që një pjesë e prodhimit të burimit gjenerues të energjisë t'i shitet furnizuesit publik, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe bashkimi i përkohshëm i shoqërive "ALBPOWER" sh.p.k., "FAVINA" sh.p.k. dhe "FAVINA 1" sh.p.k. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

ANEKSI 1

N/STACIONI ELEKTRIK				
Sipas Sistemit Koordinativ Gauss-Kruge			Sipas Sistemit Koordinativ KRGJSH	
Nr	X	Y	X	Y
1	4478029	4484623	562673	4484723
2	4478077	4484602	562721	4484703
3	4478051	4484541	562696	4484641
4	4478003	4484561	562648	4484661
SIPERFAQE SHESHI = 3500 m2				

ZONA 1(Sheshi i Turbinës 1)				
Sipas Sistemit Koordinativ Gauss-Kruge			Sipas Sistemit Koordinativ KRGJSH	
Nr	X	Y	X	Y
1	4478779	4483884	563431	4483992
2	4478749	4483957	563400	4484065
3	4478709	4483945	563361	4484053
4	4478718	4483897	563370	4484005
5	4478731	4483866	563383	4483974
6	4478761	4483842	563414	4483950
7	4478777	4483848	563430	4483956
SIPERFAQE SHESHI = 5000 m2				

ZONA 2 (Sheshi i Turbinës 2)				
Sipas Sistemit Koordinativ Gauss-Kruge			Sipas Sistemit Koordinativ KRGJSH	
Nr	X	Y	X	Y
1	4479144	4483762	563798	4483875
2	4479187	4483750	563841	4483863
3	4479230	4483725	563884	4483839
4	4479219	4483696	563873	4483809
5	4479166	4483697	563820	4483810
6	4479135	4483714	563789	4483827
7	4479132	4483747	563786	4483860
SIPERFAQE SHESHI = 4500 m2				

ZONA 3 (Sheshi i Turbinës 3)				
Sipas Sistemit Koordinativ Gauss-Kruge			Sipas Sistemit Koordinativ KRGJSH	
Nr	X	Y	X	Y
1	4479465	4483597	564121	4483713
2	4479463	4483619	564118	4483735
3	4479476	4483633	564131	4483749
4	4479489	4483637	564144	4483754
5	4479540	4483627	564195	4483744
6	4479555	4483618	564210	4483735
7	4479561	4483605	564216	4483722
8	4479586	4483585	564242	4483703
9	4479590	4483569	564246	4483687
10	4479567	4483565	564223	4483682
11	4479488	4483584	564144	4483701
SIPERFAQE SHESHI = 5600 m2				

ZONA 4 (Sheshi i Turbinës 4)				
Sipas Sistemit Koordinativ Gauss-Kruge			Sipas Sistemit Koordinativ KRGJSH	
Nr	X	Y	X	Y
1	4480064	4483610	564719	4483733
2	4480045	4483605	564700	4483728
3	4480003	4483607	564658	4483729
4	4479998	4483609	564653	4483731
5	4479996	4483676	564651	4483798
6	4480034	4483699	564688	4483822
7	4480060	4483692	564714	4483815
SIPERFAQE SHESHI = 5480 m2				

ZONA 5 (Sheshi i Turbinës 5)				
Sipas Sistemit Koordinativ Gauss-Kruge			Sipas Sistemit Koordinativ KRGJSH	
Nr	X	Y	X	Y
1	4480462	4483607	565117	4483735
2	4480456	4483627	565111	4483755
3	4480453	4483659	565108	4483786
4	4480484	4483664	565139	4483792
5	4480545	4483670	565200	4483799
6	4480577	4483634	565232	4483763
7	4480562	4483621	565217	4483750

8	4480540	4483624	565195	4483752
9	4480468	4483607	565123	4483735
SIPERFAQE SHESHI = 5400 m2				

ZONA 6 (Sheshi i Turbinës 6)				
Sipas Sistemit Koordinativ Gauss-Kruge			Sipas Sistemit Koordinativ KRGJSH	
Nr	X	Y	X	Y
1	4481124	4483556	565780	4483691
2	4481083	4483590	565739	4483725
3	4481004	4483519	565660	4483653
4	4481018	4483472	565675	4483606
5	4481054	4483486	565711	4483620
6	4481093	4483517	565749	4483652
SIPERFAQE SHESHI = 7000 m2				

ZONA 7 (Sheshi i Turbinës 7)				
Sipas Sistemit Koordinativ Gauss-Kruge			Sipas Sistemit Koordinativ KRGJSH	
Nr	X	Y	X	Y
1	4481614	4483841	566267	4483982
2	4481595	4483843	566248	4483983
3	4481496	4483838	566149	4483977
4	4481498	4483873	566150	4484012
5	4481520	4483883	566172	4484023
6	4481574	4483888	566226	4484028
7	4481615	4483885	566267	4484026
SIPERFAQE SHESHI = 5100 m2				

ZONA 8 (Sheshi i Turbinës 8)				
Sipas Sistemit Koordinativ Gauss-Kruge			Sipas Sistemit Koordinativ KRGJSH	
Nr	X	Y	X	Y
1	4482249	4483771	566902	4483919
2	4482197	4483777	566850	4483924
3	4482196	4483791	566849	4483938
4	4482195	4483821	566848	4483968
5	4482200	4483864	566852	4484011
6	4482223	4483867	566875	4484015
7	4482250	4483871	566902	4484019
8	4482251	4483822	566904	4483970
SIPERFAQE SHESHI = 5000 m2				

ZONA 9 (Sheshi i Turbinës 9)				
Sipas Sistemit Koordinativ Gauss-Kruge			Sipas Sistemit Koordinativ KRGJSH	
Nr	X	Y	X	Y
1	4482213	4484219	566861	4484366
2	4482157	4484219	566805	4484366
3	4482149	4484265	566797	4484412
4	4482157	4484310	566804	4484457
5	4482169	4484328	566816	4484475
6	4482216	4484326	566863	4484473
7	4482208	4484280	566856	4484427
8	4482206	4484270	566854	4484417
9	4482208	4484255	566856	4484402
SIPERFAQE SHESHI = 6000 m2				



VENDIM
Nr. 31, datë 21.1.2026

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË SHPENZIMEVE, PËR VITIN 2026, TË ENTIT RREGULLATOR TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA (ERRU)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 11, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e planit të shpenzimeve, për vitin 2026, të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, në shumën 76 762 426 (shtatëdhjetë e gjashtë milionë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e katërqind e njëzet e gjashtë) lekë, sipas pasqyrës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

ENTI RREGULLATOR I UJIT (ERRU)

Pasqyra nr. 1

PLANI I SHPENZIMEVE PËR VITIN 2026

Nr.	Emërtimi i shpenzimeve	Viti 2026 (lekë)
1.	Pagat dhe shtesat e tjera	49,895,370
2.	Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	7,921,710
3.	Shërbime e furniturë	17,202,960
4.	Investime	1,742,386
	TOTALI	**76,762,426**

VENDIM
Nr. 36, datë 21.1.2026

PËR FINANCIMIN E SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE SPITALORE NGA SKEMA E DETYRUESHME E SIGURIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR, PËR VITIN 2026

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 87/2025, "Për buxhetin e vitit 2026", dhe të nenit 10, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Financimin nga skema e detyrueshme e sigurimeve shëndetësore të paketës së shërbimeve të ofruara në spitalet publike, sipas listës së shërbimeve në shtojcën nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Spitali e ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me standardet, treguesit e cilësisë e të performancës, protokollet e diagnozës e të trajtimit, të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

3. Buxheti për mbulimin e paketës së shërbimeve spitalore, sipas listës së shërbimeve që ofron çdo spital, ndahet sipas shtojcës nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor lidh kontratat me spitalet për financimin e paketave të shërbimeve shëndetësore të ofruara prej tyre, në përputhje me indikatorët e performancës spitalore.

5. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor financon paketën e shërbimeve spitalore të kontraktuara me këto metoda:

a) Buxhetim me zëra shpenzimesh, për:

i. paga dhe shpenzime të tjera lidhur me pagën e personelit;

ii. kontribute për sigurime shëndetësore e shoqërore të personelit;

iii. mallra e shërbime të tjera.

b) Buxhetim për pagesën e paketave të shërbimeve me çmime të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Buxhetimi detajohet për çdo spital në zëra shpenzimesh me vendim të Këshillit Administrativ të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor;

c) Buxhetim për spitalet Durrës e "Memorial" Fier. Detajimi në zëra shpenzimesh i buxhetit miratohet nga bordet e këtyre spitaleve. Fondi financon dy spitalet nëpërmjet transfertave në llogaritë bankare që kanë spitalet në bankat e nivelit të dytë.

6. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor financon spitalet, në zbatim të vendimit nr. 258, datë 24.4.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kontratës së koncesionit/ partneritetit publik privat për ofrimin e shërbimit laboratorik të spitaleve universitare, rajonale dhe atyre bashkiake të Sarandës dhe Lushnjës". Fondi rishikon financimin e spitaleve për këtë kontratë gjatë vitit, me vendim të Këshillit Administrativ, me propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

7. Spitali është përgjegjës për zbatimin e buxhetit të kontraktuar, sipas zërave të përcaktuar të buxhetit, në përputhje me indikatorët dhe aktivitetin e shërbimit spitalor.

8. Rishpërndarja e buxhetit ndërmjet spitaleve bëhet brenda një kufiri prej 3 (tre) % të buxhetit të spitaleve, me vendim të Këshillit Administrativ të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

9. Një fond jo më i madh se 30 (tridhjetë) % e buxhetit vjetor, i planifikuar për shërbimet spitalore, mbahet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për ta shpërndarë gjatë vitit, me vendim të Këshillit Administrativ të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, përkatësisht, për:

a) financimin e shërbimit spitalor gjatë vitit;

b) pagesat e paketave të shërbimeve të veçanta, të ofruara nga shërbimet spitalore, publike e jopublike, brenda vendit, të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave;

c) pagesat për kujdes shëndetësor në institucione jopublike, brenda e jashtë vendit, sipas miratimit, rast pas rasti, me vendim të Këshillit të Ministrave;

ç) pagesat për kujdes shëndetësor, sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të nënshkruara;

d) pagesat e shërbimeve të kryera për llogari të spitaleve publike nga operatorë të kontraktuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;

dh) transferta për individët (mjekë në shërbimet spitalore).

10. Shpenzimet kapitale për investimet në spitale mbulohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Spitalet paraqesin kërkesën për investime në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

11. Burime të tjera financimi për spitalet janë fondet e krijuara nga të ardhurat e realizuara gjatë veprimtarisë së tyre dhe nga dhurimet, të cilat përdoren tërësisht nga vetë spitali. Përdorimi i të ardhurave dytësore miratohet nga bordi drejtues i spitaleve për spitalet që kanë përfituar autonominë menaxheriale. Për spitalet e tjera, përdorimi i të ardhurave bëhet bazuar në procedurat e miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Këto të ardhura vlerësohen si të ardhura jashtë limitit, të cilat mbarten në vitin buxhetor pasardhës.

12. Spitali zbaton sistemin e referimit dhe tarifat për shërbimet me pagesë, të miratuara nga ministri i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, me përjashtim të spitaleve që kanë përfituar autonominë financiare.

13. Numri i përgjithshëm i punonjësve të spitaleve, që financohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, është 13 200 (trembëdhjetë mijë e dyqind) veta.

14. Për raste të veçanta të mungesës së mjekut specialist në shërbime të ndryshme të spitaleve rajonale, bashkiake, ministri i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, brenda numrit të përgjithshëm të personelit spitalor, urdhëron kontraktimin, për një periudhë të caktuar, të mjekëve specialistë. Mjekët e përcaktuar në këtë pikë, përveç pagës, trajtohen financiarisht me një bonus deri në 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë në muaj. Vlera e bonusit përcaktohet, rast pas rasti, nga ministri i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, bazuar në vlerësimin e komisionit përkatës. Ky bonus, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, trajtohet sipas shkronjës "e", të pikës 2, të kreut II, të vendimit nr. 77, datë 28.1.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor", të ndryshuar.

15. Mjekët e kontraktuar, sipas pikës 14, të këtij vendimi, nuk e përfitojnë shpërblimin sipas shkronjave "a" e "b", të pikës 17.6, të vendimit nr. 424, datë 26.6.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave e shtesave mbi pagë, kompensime dhe trajtime të tjera financiare të punonjësve të sistemit shëndetësor në institucionet shëndetësore, në sistemin e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, në strukturat shëndetësore të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit".

16. Për spitalet rajonale, bashkiake, që nuk plotësojnë nevojat me personel mjek të strukturës në shërbimin e urgjencës, ministri i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale urdhëron kontraktimin e mjekëve të përgjithshëm dhe kryerjen e shërbimit nga mjekë të qendrave shëndetësore të shërbimit parësor.

17. Numri i pedagogëve me kontratë shërbimi për spitalet universitare miratohet çdo vit nga ministri i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Masa e shpërblimit mujor të mjekëve pedagogë të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, bazohet në aktivitetin mjekësor e në kohën e angazhimit në strukturat shëndetësore universitare dhe nuk mund të jetë më e lartë se masa e shpërblimit mujor të drejtuesit të shërbimit me gradën "Doktor i shkencave". Pagesa e tyre bëhet nga buxheti për shërbimet e spitalit.

18. Financimi i institucioneve dhe i shërbimeve, të përcaktuara në shtojcën nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi, bëhet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor vetëm kundrejt shtesave përkatëse në buxhet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

19. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Financave dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet nga data 1 janar 2026.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA NR. 1
LISTA E SHËRBIMEVE SPITALORE QË DO TË FINANCOHEN NGA FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR

I. SPITALET UNIVERSITARE

1. Shërbimi i kardiologjisë dhe kardiologjisë invazive;

2. Shërbimi i kardiokirurgjisë;

3. Shërbimi i kirurgjisë angiovaskulare;
4. Shërbimi i hematologjisë;
5. Shërbimi i gastro-hepato-enterologjisë;
6. Shërbimi i endokrinologjisë;
7. Shërbimi i nefrologjisë dhe hemodializës;
8. Shërbimi i anestezi-reanimacionit;
9. Shërbimi i urgjencave polivalente;
10. Shërbimi i hipertonisë dhe i mjekësisë interne;
11. Shërbimi i alergologjisë;
12. Shërbimi i reumatologjisë;
13. Shërbimi i dermatologjisë;
14. Shërbimi i traumatologjisë;
15. Shërbimi i ortopedisë;
16. Shërbimi i okulistikës;
17. Shërbimi i ORL-së;
18. Shërbimi i kirurgjisë oro-maksilo-faciale (OMF);
19. Shërbimi i urgjencës kirurgjikale;
20. Shërbimi i kirurgjisë digjestive;
21. Shërbimi i urologjisë;
22. Shërbimi i djegie-plastikës;
23. Shërbimi i neurologjisë;
24. Shërbimi neurovaskular (stroke dhe poststroke);
25. Shërbimi i neurokirurgjisë;
26. Shërbimi i neuroradiologjisë diagnostike dhe intervencionuese;
27. Shërbimi i onkologjisë;
28. Shërbimi i sëmundjeve infektive;
29. Shërbimi i pediatrisë së specialiteteve;
30. Shërbimi i onkohematologjisë pediatrike;
31. Shërbimi i pediatrisë infektive;
32. Shërbimi i urgjencës dhe i pediatrisë së përgjithshme;
33. Shërbimi i kirurgjisë infantile;
34. Shërbimi i reanimacionit pediatrik;
35. Shërbimi i laboratorëve (klinikë-biokimikë, mikrobiologjikë, imunologjikë, të anatomisë patologjike);
36. Shërbimi i gjenetikës mjekësore;
37. Shërbimi i imazherisë dhe i mjekësisë nukleare;
38. Shërbimi i mjekësisë rehabilituese;
39. Shërbimi i statistikave;
40. Shërbimi i pneumologjisë;
41. Kirurgjia torakale;
42. Shërbimi i gjinekologjisë;
43. Shërbimi i obstetrikës;
44. Shërbimi i patologjisë së barrës;
45. Shërbimi i neonatologjisë;
46. Shërbimi i farmacisë;
47. Shërbimi i konsultave të specializuara ambulatore;
48. Shërbimi i toksikologjisë klinike;
49. Shërbimi i psikiatrisë (QSUT);
50. Kontrolli i infeksioneve spitalore;
51. Shërbimi i urgjencës paraspitalore;
52. Banka e gjakut.

II. QENDRA SPITALORE RAJONALE

II.A. Shërbimet e qendrës spitalore rajonale përcaktohen rast pas rasti në urdhrin e ministrit për ngritjen e qendrës spitalore rajonale.

1. Shërbimi i urgjencës;
2. Shërbimi Universitar i Sëmundjeve Polmonare;
3. Shërbimi i mjekësisë interne;
4. Shërbimi i kardiologjisë dhe kardiologjisë invazive;
5. Shërbimi i kardiokirurgjisë;
6. Shërbimi i kirurgjisë abdominale dhe ortopedike;
7. Shërbimi i kirurgjisë torakale;
8. Shërbimi i anestezi-reanimacionit;
9. Shërbimi imazherisë;
10. Shërbimi i referencës së tuberkulozit;
11. Shërbimi i laboratorit;
12. Shërbimi i konsultave;
13. Shërbimi i pediatrisë;
14. Shërbimi i farmacisë;
15. Njësi komunitare lindjeje;
16. Riaftësim dhe rehabilitim.

III. SPITALET NË NIVEL QARKU (SPITALET RAJONALE)

Spitalet publike të përgjithshme në nivel qarku ofrojnë:

1. Shërbimin e urgjencës;
2. Shërbimin e mjekësisë së përgjithshme;
3. Shërbimin e kirurgjisë së përgjithshme, ortopedi-traumatologjisë, urologjisë, ORL, okulistikës, angiologjisë, *max-facial*;
4. Shërbimin e obstetrikë-gjinekologjisë;
5. Shërbimin e neonatologjisë;
6. Shërbimin e pediatrisë;
7. Shërbimin e imazherisë;
8. Shërbimin e mjekësisë rehabilituese;
9. Shërbimin e anatomisë dhe histologjisë patologjike;
10. Shërbimin e laboratorëve kliniko-biokimikë të mikrobiologjisë;
11. Shërbimin e anestezi-reanimacionit;

12. Shërbimin e farmacisë;
13. Shërbimin e onkologjisë (kimioterapisë, kujdesi paljativ);
14. Kontrollin e infeksioneve spitalore;
15. Shërbimin psikosocial;
16. Shërbimin e konsultave të specializuara (poliklinika e specialiteteve);
17. Bankën e gjakut.

IV. SPITALET NË NIVEL BASHKIE

Spitalet publike të përgjithshme në nivel bashkie ofrojnë:
1. Shërbimin e urgjencës;
2. Shërbimin e mjekësisë së përgjithshme;
3. Shërbimin e kirurgjisë së përgjithshme;
4. Shërbimin e pediatrisë dhe obstetrikë-gjinekologjisë, neonatologji;
5. Shërbimin e imazherisë;
6. Shërbimin e laboratorëve kliniko-biokimikë të mikrobiologjisë;
7. Shërbimin e anestezi-reanimacionit;
8. Shërbimin e farmacisë;
9. Shërbimin ambulator të specializuar;
10. Bankën e gjakut.

V. SPITALET DITORE

1. Ndihmë e parë mjekësore për trajtim dhe kurim brenda 24 orëve.

SHTOJCA NR. 2
BUXHETI I SHËRBIMIT SPITALOR 2026

INSTITUCIONET	ARTIKUJT						total
	art.600	art.601	art.602	art. 602 PPP laboratorë	art. 604	rezervë	
QSR BERAT	570,000	95,100	172,000	64,000	0	0	901,100
BULQIZE	123,000	20,500	24,096	0	0	0	167,596
DELVINE	58,000	9,680	5,600	0	0	0	73,280
DEVOLL	74,600	12,450	9,600	0	0	0	96,650
DIBER	418,000	69,800	112,800	33,000	0	0	633,600
ELBASAN	739,500	123,420	232,400	110,000	0	0	1,205,320
FIER	597,000	99,650	203,200	115,000	0	0	1,014,850
GRAMSH	185,000	30,850	28,520	0	0	0	244,370
GJIROKASTER	349,000	58,250	107,200	39,000	0	0	553,450
HAS	70,000	11,650	12,800	0	0	0	94,450
KOLONJE	122,000	20,350	16,000	0	0	0	158,350
KORCE	684,000	114,200	255,200	85,000	0	0	1,138,400
KRUJE	190,000	31,700	26,360	0	0	0	248,060
KUKES	399,000	66,600	105,600	37,000	0	0	608,200
KURBIN	141,000	23,500	29,600	0	0	0	194,100
LEZHE	428,000	71,400	170,400	65,000	0	0	734,800
LIBRAZHD	230,000	38,400	47,440	0	0	0	315,840
LUSHNJE	349,000	58,250	92,400	45,000	0	0	544,650
M.MADHE	40,000	6,650	5,280	0	0	0	51,930
MALLAKASTER	65,500	10,900	10,400	0	0	0	86,800
MAT	202,000	33,700	33,200	0	0	0	268,900
MIRDITE	155,000	25,850	24,800	0	0	0	205,650
PEQIN	55,500	9,250	6,000	0	0	0	70,750
PERMET	120,000	20,000	28,000	0	0	0	168,000
POGRADEC	266,000	44,400	70,800	0	0	0	381,200
PUKE	151,000	25,200	32,096	0	0	0	208,296
SARANDE	252,000	42,000	97,600	35,000	0	0	426,600
SKRAPAR	119,000	19,870	14,400	0	0	0	153,270
SHKODER	880,700	147,220	308,000	70,000	0	0	1,405,920
TEPELENE	122,000	20,350	12,800	0	0	0	155,150
QSU "NENE TEREZA"	3,820,000	637,500	3,800,000	850,000	0	0	9,107,500
SUOGJ "MBRETERESHA GERALDINE"	470,000	78,450	290,000	33,000	0	0	871,450
SUOGJ "KOCO GLIOZHENI"	373,000	62,250	280,800	34,000	0	0	750,050
QSR "SHEFQET NDROQI"	784,000	131,000	430,400	63,000	0	0	1,408,400
TRAUMA	203,000	33,900	408,000	60,000	0	0	704,900
TROPOJE	156,000	26,000	32,280	0	0	0	214,280
VLORE	630,900	105,240	326,400	78,500	0	0	1,141,040
"MEMORIAL" FIER	0	0	0	0	900,000	0	900,000
DURRËS	0	0	0	83,500	1,500,000	0	1,583,500
Paketat e shërbimeve	0	0	0	0	3,601,579	0	3,601,579
Transferta për individët (mjekë specialistë)	0	0	0	0	10,000	0	10,000
Trajtime me VKM	0	0	0	0	20,000	0	20,000
Pagesat e shërbimeve PPP	0	0	0	0	1,515,000	0	1,515,000
rezerve	0	0	0	100,000	0	2,938,633	3,038,633
	14,592,700	2,435,480	7,862,472	2,000,000	7,546,579	2,938,633	37,375,864

SHTOJCA NR. 3
LISTA E INSTITUCIONEVE, QË NUK DO TË FINANCOHEN NGA FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR

1. Spitali Psikiatrik Vlorë;
2. Spitali Psikiatrik Elbasan;
3. Shërbimet e shëndetit mendor në rrethe;
4. Shërbimi i psikiatrisë Shkodër;
5. Qendra Kombëtare e Riaftësimit, Mirërritjes dhe Zhvillimit të Fëmijëve;
6. Shërbimi Kombëtar i Transfuzionit;
7. Qendra Kombëtare Biomjekësore.

VENDIM
Nr. 37, datë 21.1.2026

PËR PËRCAKTIMIN E ORGANIZIMIT TË BRENDSHËM TË ORGANEVE DREJTUESE E TË MËNYRËS SË FUNKSIONIMIT TË AGJENCISË KOMBËTARE TË EKONOMISË SË MBETJEVE SHA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 22, të ligjit nr. 57/2025, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve sh.a., me emrin e shkurtuar "AKEM" sh.a., është shoqëri aksionare me kapital 100% shtetëror, e themeluar me qëllim përmbushjen e objektivave të përcaktuar në ligjin nr. 57/2025, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve". Autoriteti publik, që përfaqëson shtetin si pronar të 100% të aksioneve të shoqërisë aksionare, është ministria përgjegjëse për mjedisin.

2. Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve sh.a., ofron, kundrejt pagesës, shërbimin e trajtimit fundor të mbetjeve dhe çdo shërbim tjetër, në përputhje me qëllimin e krijimit dhe statutin e saj.

3. Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve sh.a., sipas përcaktimeve në pikën 1, të këtij vendimi, themelohet, organizohet dhe funksionon me dy nivele administrimi, këshill mbikëqyrës dhe administrator, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar.

4. Kapitali fillestar për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve sh.a., është 20 000 000 (njëzet milionë) lekë.

5. Ministria e Mjedisit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, ndjek procedurat e nevojshme ligjore, për:

a) themelimin dhe miratimin e statutit të shoqërisë aksionare;

b) regjistrimin e Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve sh.a., në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

6. Organet drejtuese të Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve sh.a., sipas parashikimeve të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, janë:

a) Asambleja e Përgjithshme e Aksionarit;

b) Këshilli Mbikëqyrës;

c) Administratori.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Asamblesë së Përgjithshme të Akreditimit dhe Këshillit Mbikëqyrës rregullohen dhe funksionojnë, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, dhe parashikimeve të statutit të shoqërisë "AKEM" sh.a.

7. Këshilli Mbikëqyrës ka 5 (pesë) anëtarë, që emërohen nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarit, si më poshtë vijon:

a) 2 (dy) anëtarë, përfaqësues nga ministria përgjegjëse për mjedisin;

b) 1 (një) anëtar, përfaqësues nga ministria përgjegjëse për financat;

c) 1 (një) anëtar, përfaqësues nga ministria përgjegjëse për pushtetin vendor;

ç) 1 (një) anëtar, përfaqësues nga ministria përgjegjëse për ekonominë.

8. Kriteret e emërimit të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, periudha e emërimit apo e riemërimit të tyre, masa dhe skema e shpërblimit caktohen në statutin e shoqërisë, duke mbajtur në konsideratë parashikimet e nenit 167, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar.

9. Administratori i shoqërisë "AKEM" sh.a., emërohet, lirohet ose shkarkohet nga detyra, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar,

dhe statutit të shoqërisë. Kriteret për emërimin e drejtuesit të shoqërisë janë, si më poshtë vijon:

a) të jetë shtetas shqiptar;

b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

c) të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

ç) të ketë diplomë të nivelit "Master i shkencave" apo "Master profesional", të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 (dy) vjet akademikë ose të barasvlershme me to, sipas legjislacionit për arsimin e lartë;

d) Të ketë eksperiencë pune jo më pak se 10 (dhjetë) vjet, prej të cilave 5 (pesë) vjet në pozicione drejtuese apo menaxheriale në sektorin publik apo privat;

dh) Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna, që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi;

e) Të mos ketë konflikt interesi në ushtrimin e detyrës në përputhje me legjislacionin e konfliktit të interesave.

10. Administratori i shoqërisë "AKEM" sh.a. lirohet nga detyra, kur:

a) jep dorëheqjen;

b) mbush moshën e pensionit të pleqërisë;

c) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën;

ç) humbet shtetësinë shqiptare;

d) deklarohet i paaftë për punë nga komisioni kompetent mjekësor apo merr formë të prerë vendimi gjyqësor për kufizimin apo heqjen e zotësisë për të vepruar.

11. Administratori i shoqërisë "AKEM" sh.a., shkarkohet nga detyra kur:

a) kryen shkelje të rënda të etikës;

b) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;

